

**VENDIM I ORTAKUT TË VETËM
TË SHOQËRISË
"NOA DEVELOPMENT" SH.P.K.**

Sot më datë 11.09.2022, **Z. Gentian Sula**, shtetas shqiptar, lindur në Mat, më 09.03.1983, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I30309064B, zotërues i kuotës e cila përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë:

"NOA Development" SH.P.K., një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e themeluar ne përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numër NUIS L42203032I, me seli Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Kodi Postar 1000, Tiranë, Shqipëri, ("**Shoqëria**"),

me ane të këtij akti:

VENDOSI

1. Të fillojë procedura ligjore për emetimin e kuotave të reja të kapitalit të shoqërisë të cilat do të regjistrohen në emër të ortakut të ri, shoqëria ZIP Cloud sh.p.k me NUIS: L61531022M në shumën 229,877,069 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë. Burimi i krijimit do të jetë huaja e marre nga shoqëria ZIP Cloud shpk , sipas kontratës së lidhur ndërmjet dy shoqerive ne date 28 /12/2021.
2. Të emërojë znj.Brunilda Stefa, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal G65702149J, Auditues Ligjor, me licencë nr.182, datë 15.10.2008, të përgatisë raportin dhe modalitetet e rritjs së kapitalit të shoqërisë.
3. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë për të kryer pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) të gjitha depozitimet dhe regjistrimet përkatëse në lidhje me këtë vendim, si dhe çfarëdolloj dokumentacioni mbështetës të kërkuar nga legjislacioni i zbatueshëm. Administratori i Shoqërisë gëzon të drejtën të autorizojë palë të treta për të ndërmarrë këto veprime.

Vendim i Ortakut të Vetëm të shoqërisë "**NOA Development**" SH.P.K.

Z. Gentian Sula

Gentian Sula



**VENDIM I ORTAKUT TË VETËM
TË SHOQËRISË
"NOA DEVELOPMENT" SH.P.K.**

Sot më datë 23.09.2022, **Z. Gentian Sula**, shtetas shqiptar, lindur në Mat, më 09.03.1983, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I30309064B, zotërues i kuotës e cila përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë:

"NOA Development" SH.P.K., një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e themeluar ne përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numër NUIS L42203032I, me seli Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Kodi Postar 1000, Tiranë, Shqipëri, ("**Shoqëria**"), me ane të këtij akti:

VENDOSI

1. Të pranojë raportin e Audituesit Ligjor, znj. Brunilda Stefa për rritjen e kapitalit të shoqërisë me 229,877,069 Lekë, duke arritur shumën 229,977,069 Lekë.
2. Të miratojë rritjen e kapitalit të shoqërisë "NOA Development" SHPK me vlerën prej **229,877,069 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë**, sipas Raportit të Audituesit Ligjor.
3. Të miratojë emetimin e një kuote të re të Shoqërisë në vlerën prej **229,877,069 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë**, e cila do të përfaqësojë 99.96% të kapitalit të Shoqërisë.
4. Kuota e re do të nënshkruhet dhe zotërohet nga shoqëria "**ZIP CLOUD**" SH.P.K., një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numër NUIS L61531022M, e cila do të jetë ortake e re e Shoqërisë sipas marrëveshjes përkatëse që do të nënshkruhet ndërmjet Shoqërisë dhe ZIP CLOUD.
5. Nënshkrimi, zotërimi dhe shlyerja e kuotës së re do të realizohet duke konvertuar në kapital detyrimin ekzistues në vlerën **229,877,069 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë**, që Shoqëria ka kundrejt ZIP CLOUD sipas Marrëveshjes së Kredisë datë 28.12.2021 dhe sipas marrëdhënieve të tjera të biznesit mes Palëve.
6. Kontributi i ZIP CLOUD në kapitalin e rritur të Shoqërisë që përfaqësohet nga kuota e re me vlerë **229,877,069 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e**

shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, do të konsiderohet i shlyer duke u kompensuar me detyrimin që Shoqëria ka ndaj ZIP CLOUD me të njëjtën vlerë pra, **229,877,069 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë**.

7. Si rrjedhojë, vlera totale e kapitalit të Shoqërisë pas zmadhimit të kapitalit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet **229,977,069 lekë (dyqind e njëzet e nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë**.
8. Zmadhimi i kapitalit të pasqyrohet edhe në nenin përkatës të Statutit të shoqërisë "NOA Development" SHPK; përkatësisht, Neni 5 i Statutit (ne versionin shqip dhe atë anglisht) ndryshon si më poshtë:

"Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota me vlerë nominale në total prej 229,977,069 (dyqind e njëzet e nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

"The capital of the company consists of 2 (two) quota with a nominal value in total of 229,977,069 (two hundred twenty nine million nine hundred seventy seven thousand sixty nine) ALL.

Pas zmadhimit të kapitalit, kapitali i shoqërisë "NOA Development SHPK përbëhet si vijon:

- *Një kuotë në vlerën prej 100,000 lekë e cila zotërohet nga Z. Gentian SULA dhe përfaqëson 0.04% të kapitalit; dhe*
- *Një kuotë në vlerën prej 229,877,069 lekë e cila zotërohet nga "ZIP CLOUD" SHPK dhe përfaqëson 99.96% të kapitalit.*

After the capital increase, the capital of the company "NOA Development" SHPK consists of the following:

- *One quota in the amount of ALL 100,000 which is owned by Mr. Gentian SULA and represents 0.04% of the capital; and*
- *One quota in the amount of ALL 229,877,069 which is owned by "ZIP CLOUD" SHPK and represents 99.96% of the capital."*

9. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë për të nënshkruar marrëveshjen përkatëse të përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, çdo dokument tjetër të nevojshëm apo që lidhet me atë marrëveshje, si dhe për të kryer pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) të gjitha depozitimet dhe regjistrimet përkatëse në lidhje me këtë vendim, si dhe çfarëdolloj dokumentacioni mbështetës të kërkuar nga legjislacioni i zbatueshëm. Administratori i Shoqërisë gëzon të drejtën të autorizojë palë të treta për të ndërmarrë këto veprime.

Vendim i Ortakut të Vetëm të shoqërisë "NOA Development" SH.P.K.
Z. Gentian Sula





BRUNILDA STEFA ; Nr. i Licencës:182; Adresa: Rr. "Perlat Rexhepi"; Tel: 0692057309; Email: bruna.beluli@gmail.com

RAPORTI AUDITUESIT LIGJOR

Objekti / Misionit:

Zmadhimin i kapitalit themeltar te shoqerise

“ NOA DEVELOPMENT ” shpk

Auditues Ligjor

BRUNILDA STEFA

Tirane , me 23 SHTATOR 2022

R A P O R T

I AUDITUESIT LIGJOR **Per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise** **“ Noa Development ” shpk, Tirane**

Ne cilesine time si Auditues Ligjor i shoqerise suaj , emeruar me vendimin e Asamblese se Ortakeve te mbledhur me date 11 Shtator 2022, dhe ne zbatim te misionit te parashikuar nga neni 150 i Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar, Ju paraqes raportin tim mbi projektin per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise suaj ne shumen 229,877,029 leke, operacion per te cilin ka vendosur mbledhja e ortakeve te shoqerise me Vendim nr.1 te Asamblese se ortakeve te dates 11/09/2022.

Vleresimi dhe opinionimi im ne cilesine e Audituesit Ligjor, kryhet lidhur me sinqeritetin dhe vertetesine e gjendjes se llogarive kontabel me date 31 dhjetor 2021, te cilat mundesojne realizimin e zmadhimit te kapitalit themeltar te shoqerise “Noa Development” shpk ne shumen 229,877,029 leke.

Une kam proceduar ne kontrollin e informacioneve te dhena nga shoqeria per motivet e zmadhimit te kapitalit dhe menytrat e realizimit te tij.

Kam verifikuar gjithashtu , informacionet e shifruara qe jane paraqitur, duke kryer hapat qe i çmova te nevojshme sipas normave te profesionit .

Informacionet e shifruara te paraqitura nga shoqeria jane marre nga bilancet e nxjerra nga shoqeria deri ne vitin 2021 te cilat jane te audituar nga nje Auditues Ligjor.

Shoqeria “Noa Development” shpk eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar me date 27/09/2014 dhe e regjistruar ne regjistrin tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit me date 03/10/2014 nga ortaku I vetem z. Gentian Sula, i cili zoteron 100% te pjeseve te kapitalit.

Objekti I aktivitetit te shoqerise eshte: Aktivitete ne fushen e ndertimeve civile dhe industriale. Zbatim i punimeve te ndertimit ne vepra civile dhe industriale si dhe kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes ne vepra civile dhe industriale. Ndertimin dhe shitjen e ndertesave industriale, banesave, lokaleve, dyqaneve, zyrave, magazinave, garazheve, si dhe shitblerjen dhe drejtimin ekonomik te terreneve e pasurive te paluejtshme, si dhe cdo aktivitet qe lidhet me sa me siper. Eksportimi, importimi, tregtimi i artikujve te ndryshem. Kryerja e operacioneve te kerkimit dhe zhvillimit te hidrokarbureve ne blloqet e miratuara ne marveshjet hidrokarbure. Ndertimi dhe montimi i te gjitha mjeteve dhe pajisjeve te kerkuara ne keto operacione si dhe shpimi i puseve te kerkimit, zhvillim konturimit dhe shfrytezimit. Perdorimi, shitja, shkembimi, eksporti dhe posedimi i naftes

se nxjerre ne vendburimet qe do te zbulohen. Kryerja e aktivitetit ne fushen e biletarise interurbane. Kryerja e aktivitetit koncesionar ne fusha dhe objekte te ndryshme si porte, rruge, hidrocentrale, etj., si dhe ndertimin dhe menaxhimin e ketyre industrive.

Aktualisht sipas ekstraktit te QKB perfaqesuesi ligjor I shoqerise eshte zj. Eranda Nepravishta. Kapitali i nenshkruar i shoqerise ne momentin e krijimit te saj ka qene 100,000 leke , i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 1,000 leke kuota.

Bilanci I Shoqerise "Noa Development" shpk i mbyllur me date 10 Shtator 2022, para zmadhimit te kapitalit paraqitet si me poshte:

NOA DEVELOPMENT shpk

Pasqyrat e pozicionit financiar ne daten 10.09.2022

NE DATEN PARA ZMADHIMIT TE KAPITALIT

Nr	A K T I V E T	2022
	Aktivitet Afatshkurtra	
	▶ Aktivitet monetare	83,017
	1 <i>Banka</i>	83,017
	▶ Investime	
	1 <i>Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit</i>	
	▶ Të drejta të arkëtueshme	204,933,597
	1 <i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	6,442,681
	2 <i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	198,419,604
	3 <i>Kerkesa te tjera</i>	71,312
	▶ Inventarët	0
	1 <i>Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	0
	2 <i>Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte</i>	
	3 <i>Produkte të gatshme</i>	
	4 <i>Mallra</i>	
	▶ Shpenzime të shtyra	0
I	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA	205,016,614
	Aktivitet Afatgjata	
	▶ Aktive financiare	0
	1 <i>Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit</i>	
	2 <i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit</i>	
	3 <i>Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	
	▶ Aktivitet materiale	3,332,629
	1 <i>Toka dhe ndërtesa</i>	
	2 <i>Impiante dhe makineri</i>	
	3 <i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	3,332,629
	4 <i>Parapagime për aktive materiale dhe në proces</i>	
	▶ Kapitali i nënshkruar i papaguar	0
II	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA	3,332,629
	AKTIVE TOTALE	208,349,243

NOA DEVELOPMENT shpk

Pasqyrat e pozicionit financiar ne daten 31.08.2022
NE DATEN PARA ZMADHIMIT TE KAPITALIT

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	2022
	▶ Detyrime afatshkurtra:	269,465,200
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>	255,040,841
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	0
3	<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>	
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	14,051,256
5	<i>Të pagueshme ndaj ortakeve</i>	
6	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit</i>	
7	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	
8	<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	325,340
9	<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	47,763
I	Totali i Detyrimeve afatshkurtera	269,465,200
	▶ Detyrime afatgjata:	0
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>	
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	
3	<i>Arkëtimet në avancë për porosi</i>	
	▶ Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	
	▶ Të ardhura të shtyra	0
	▶ Provizione:	
II	Totali i Detyrimeve afatgjata	0
A	DETYRIMET TOTALE	269,465,200
	▶ Kapitali dhe Rezervat	
	▶ Kapitali i Nënshkruar	100,000
	▶ Primi i lidhur me kapitalin	
	▶ Rezerva Rivleresimi	
	▶ Rezerva të tjera	
	▶ Fitimi i pashpërndarë	3,471,960
	▶ Fitim / Humbja e Vitit	-64,687,917
B	Totali i Kapitalit	-61,115,957
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	208,349,243

Nga bilanci financiar I shoqerise shihet qe kapitali themeltar , rezervat dhe fitimi I shoqerise rezultojne ne Shumen -61,115,957 leke nga te cilat shuma 100,000 leke Kapital themeltar, shuma 3,471,960 leke fitime te mbartura nga periudhat paraardhese dhe shuma -62,115,957 leke humbje e rezultuar gjate periudhes ushtrimore 2021.

Shoqëria ka vendosur që të bëjë rritje kapitali nepermjet emetimit të kuotave të reja të kapitalit, që do të regjistrohen në emër të ortakut të ri, i cili është shoqëria "ZIP Cloud" shpk. Shoqëria "Noa Development" shpk dhe shoqëria "Zip Cloud" shpk janë pale të lidhura dhe gjendja e transaksioneve ndërmjet tyre për rritjen e kapitalit rezultoi në shumën 229,877,069 leke, shumë për të cilën është vendosur të bëhet rritja e kapitalit.

I. Motivet e zmadhimit të kapitalit

- Gjendja negative e kapitaleve të veta.
- Zmadhimi i kapitalit do të shërbejë rritjes së aktivitetit të shoqërisë.

Me datë 28 Dhjetor 2021 ndërmjet shoqërisë "Noa Development" shpk dhe shoqërisë "Zip Cloud" shpk është lidhur një kontratë huadhënie (e cila i bashkëngjitet këtij raporti), sipas të cilit shoqëria "Zip Cloud" shpk do të japë një hua shoqërisë "Noa Development" shpk në shumën 1,800,000 EUR. Deri në fund të vitit 2021 sipas statementeve të bankës është bërë derdhje e kësaj huaje në llogaritë bankare të shoqërisë "Noa Development" shpk. Gjithashtu nga transaksionet me paletë e lidhura rezultoi edhe një detyrim i shoqërisë "Noa Development" shpk ndaj shoqërisë "Zip Cloud" shpk në shumën 12,509,069 ALL. Në kontabilitetin e shoqërisë është njohur në detyrime afatshkurtra në zerin "Tituj të huamarrjes", huaja e marrë nga shoqëria "Zip Cloud" shpk në shumën 1,800,000 EUR, ose e perkthyer me kursin 120.76 të Bankës së Shqipërisë të datës 31/12/2021, shuma në leke 217,368,000 ALL dhe gjithashtu është njohur si detyrim afatshkurter edhe shuma 12,509,069 ALL e cila rezultoi nga transaksionet midis paleve. Gjate vitit 2022 nuk është bërë shlyerje e detyrimeve të huase nga ana e shoqërisë "Noa Development" shpk për shoqërinë "Zip Cloud" shpk dhe situata e detyrimeve afatshkurtra në momentin për rritjen e kapitalit është 229,877,069 ALL, shuma kjo që paraqitet në pasqyrat financiare të të dyja shoqërive. Meqenëse shoqëria "Noa Development" shpk është në pamundësi likuiditetesh për shlyerjen e huase, si dhe rezultoi të ketë kapitalet e veta negative ortaku i vetëm i shoqërisë me vendimin Nr.1 të datës 11 Shtator 2022 ka vendosur të bëjë emetimin e kuotave të reja në shumën 229,877,069 ALL, aq sa është edhe detyrimi ndaj shoqërisë "Zip Cloud" shpk, në emër të të cilit do të regjistrohet kuota e re.

Nga ana e saj edhe shoqëria "Zip Cloud" shpk ka rënë dakord që nënshkrimi, zotërimi dhe shlyerja e kuotës së kapitalit do të realizohet duke konvertuar në kapital detyrimin Ekzistues në vlerën 229,877,069 ALL. Kjo rritje kapitali përveçse do të bëjë pozitive kapitalet e veta të shoqërisë do të shërbejë edhe rritjes së aktivitetit nepermjet kryerjes së investimeve në periudhat e ardhme.

II Vlera e zmadhimit dhe menyrat e rritjes së tij

Kapitali themeltar propozohet të arrijë në vlerën 229,877,069 leke nga të cilat:

- 100,000 leke kapitali i nënshkruar
- 229,877,069 leke shtese kapitali në vitin 2022

Shtesa e kapitalit do të realizohet nga huaja që shoqëria "Noa Development" shpk ka marrë nga shoqëria "Zip Cloud" shpk, sipas kontratës të lidhur midis tyre, me datë 28

Dhjetor 2021 ne shumen 1,800,000 EUR,ose e perkthyer me kursin 120.76 te Bankes se Shqiperise me date 31/12/2021 ,ne shumen 217,368,000 leke , si dhe nga detyrime ndermjet paleve te lidhura per transaksione ne shumen 12,509,069 leke per te cilen eshte vendosur nga asambleja e ortakeve me vendimin e saj te dates 11 Shtator 2022.

III. Percaktimi i kuotave per secilin ortak

- 1- Ne date 27/09/2014, ne themelimin e saj shoqeria ka patur nje kapital themeltar 100,000 leke.
- 2- Ne baze te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise date 11/09/2022 eshte vendosur te behet zmadhimi i kapitalit te shoqerise, i cili arrin vleren 229,977,069 leke.

Pas zmadhimit te kapitalit, kontributi i ortakeve ne kapitalin e shoqerise " Noa Development " sh.p.k. , i cili arrin vleren **229,977,069 leke**, eshte i ndare si me poshte:

Emer mbiemer -----	Kontribut/fillestar -----	Shtese e Kapitali -----	Kontribut/total -----
Gentian Sula	0,04 % 100,000	0	100,000
ZIP Cloud shpk	99,96 % 0	229,877,069	229,877,069
SHUMA	100,000	229,877,069	229,977,069

Regjistrimet kontabile te veprimeve lidhur me kapitalet e veta te shoqerise jane kryer ne menyre te plote e te rregullt ne perputhje me kerkesat e ligjit nr.25/2018 date 10.05.2018 " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe jane pasqyruar ne kontabilitetin e te dy shoqerive qe marrin pjese ne kete operacion financiar.

Bilanci I Shoqerise pas rritjes se kapitalit themeltar paraqitet si me poshte :

NOA DEVELOPMENT shpk

Pasqyrat e pozicionit financiar ne daten 20.09.2022
NE DATEN PAS ZMADHIMIT TE KAPITALIT

Nr	A K T I V E T	2022
	Aktivitet Afatshkurtra	
	▶ Aktivitet monetare	83,017
	1 <i>Banka</i>	83,017
	▶ Investime	
	1 <i>Në tituj pronësie të njësisve ekonomike brenda grupit</i>	
	2 <i>Aksionet e veta</i>	
	▶ Të drejta të arkëtueshme	204,933,597
	1 <i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	6,442,681
	2 <i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	198,419,604
	3 <i>Kerkesa te tjera</i>	71,312
	▶ Inventarët	0
	1 <i>Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	
	2 <i>Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte</i>	
	3 <i>Produkte të gatshme</i>	
	4 <i>Mallra</i>	
	▶ Shpenzime të shtyra	0
I	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA	205,016,614
	Aktivitet Afatgjata	
	▶ Aktive financiare	0
	1 <i>Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit</i>	
	2 <i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit</i>	
	3 <i>Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	
	4 <i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	
	▶ Aktivitet materiale	3,332,629
	1 <i>Toka dhe ndërtesa</i>	
	2 <i>Impiante dhe makineri</i>	
	3 <i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	3,332,629
	4 <i>Parapagime për aktive materiale dhe në proces</i>	
	▶ Kapitali i nënshkruar i papaguar	0
II	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA	3,332,629
	AKTIVE TOTALE	208,349,243

NOA DEVELOPMENT shpk

Pasqyrat e pozicionit financiar ne daten 20.09.2022
NE DATEN PAS ZMADHIMIT TE KAPITALIT

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	2022
	▶ Detyrime afatshkurtra:	39,588,131
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>	25,163,772
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	0
3	<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>	
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	14,051,256
5	<i>Të pagueshme ndaj ortakeve</i>	
6	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit</i>	
7	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	
8	<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	325,340
9	<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	47,763
I	Totali i Detyrimeve afatshkurtera	39,588,131
	▶ Detyrime afatgjata:	0
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>	
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	
3	<i>Arkëtimet në avancë për porosi</i>	
	▶ Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	0
	▶ Të ardhura të shtyra	0
	▶ Provizione:	
II	Totali i Detyrimeve afatgjata	0
A	DETYRIMET TOTALE	39,588,131
	▶ Kapitali dhe Rezervat	
	▶ Kapitali i Nënshkruar	229,977,069
	▶ Primi i lidhur me kapitalin	
	▶ Rezerva Rivleresimi	
	▶ Rezerva të tjera	
	▶ Fitimi i pashpërndarë	3,471,960
	▶ Fitim / Humbja e Vitit	-64,687,917
B	Totali i Kapitalit	168,761,112
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	208,349,243

OPINION

Duke pasur parasysh se une kam permbushur misionin tim per vleresimin e aktiveve dhe pasiveve te shoqerise bazuar ne vlerat e bilancit date 20/09/2022, vertetoj se llogarite kontabile te kesaj shoqerise per efekt te vleresimit te tyre per zmadhimin e kapitalit shprehin vleren pasurore reale te shoqerise qe perfaqesohet nepermjet kapitalit te saj themeltar ne shumen 229,977,069 leke.

Nuk kam verejteje lidhur me shkaqet dhe kushtet e ketij operacioni i cili do te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise suaj nga 100,000 leke ne 229,977,069 leke i perbere nga 2 kuota njera me vlere nominale 100,000 leke dhe tjetra me vlere nominale 229,877,069 leke kuota.

Tirane, me 23/09/2022

Brunilda STEFA

AUDITUES LIGJOR
Licenca Nr. 182

